

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË – DEPARTAMENTI I PËRGJTHSHËM –DIVIZIONI PENAL , me gjyqtarin Adem Shabani dhe asistentin Muedin Rexhepi , në çështjen penale kundër të akuzuarëve:M.Y. nga fshati , dhe F.H. nga fshati që të dy nga Komuna e Shtërpcës , me të cile kryen veç e veç veprën penale “raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve”nga neni 399 par 1 pika 1.5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP. nr.2121-6/14 të dt. 24.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit publik për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit, Visar Musa , të akuzuarëve M.Y. me mbrojtësin e tij me autorizim J.R. dhe të akuzuarit F.H. me mbrojtësin e tij ..I.M. me datë 16.09.2016 mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

KUNDËR:

1. M.Y. nga fshati Komuna e Shtërpcës , i lindur në të njetin vend më data e lindjes.... nga i ati M..... e ëma H.... e gjinisë P..... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme , i pa martuar, punon privatë, i pa martuar i gjendjes së mesme ekonomike i pa denuar deri më tani mbrohet në liri,-

2. F.H. nga fshati Komuna e Shtërpcës , i lindur në të njetin vend më data e lindjes , nga i ati F.... , e ëma S.... , e gjinisë B..... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ,ka të kryer shkollen e mesme, i martuar baba i tre fëmive, i gjendjes së mesme ekonomike i pa denuar deri më tani mbrohet në liri,-

JANË FAJTORË

Sespe:

1. M. Y.

- me datën 19.08.2014, ,rreth orës 17:20,në zonen e vikendit Brezovicë,gjatë një kontrole nga ana e Policisë është hasur duke drejtuar keamionin e markës ngjyrë e zezë,në të cilin kamion pa autorizim kishte vendosur targat e regjistrimit ,të cila i përkasin kamionit të markës ,ngjyrë e kuqe i cili që nga data 12.03.2013 figuron se është ç’lajmruar.

2.F.H.

- me datën 17.08.2014, me qëllim të falsifikimit të dokumentave gjatë ditës i ka vendosur në xhamin e përparmë të markës ,me ngjyrë të zezë pa autorizim targat e regjistrimit, të cilat i poërkasin kamionit të markës ,ngjyrë e kuqe,me qëllim që të oproj me të, e që nga infformacioni që është siguruar vërtetohet se targa nga data 12.03.2013, janë ç’lajmruar nga ana e të pandehurit,-

-me të cile kryen veç e veç veprën penale “raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve”nga neni 399 par 1 pika 1.5 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarit i

G J Y K O N

1.Të akuzuarit **M.Y.** i shqipton **dënimin me gjobë** në shumë prej 150 / njëqind e pesëdhjetë / Eurosh, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

2.Të akuzuarit **F.H.** i shqipton **dënimin me gjobë** në shumë prej 150 / njëqind e pesëdhjetë / Eurosh, të cilin dënim të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se personat e dënuar nuk dëshirojnë ose nuk mundën ta paguajn dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t’i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

Të akuzuarit obligohen që në emër të paushallin gjyqësor në mënyrë solidare të paguajn shumën prej 40 €, pra secili veç e veç nga 20 € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën të evidentuar si PP. nr.2121-6/14 të dt. 24.11.2015 ka akuzuar të akuzuarit: M.Y. nga fshati dhe F.H. nga fshati që të dy nga Komuna e Shtërpcës me të cilën kryen veç e veç veprën penale “raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve”nga neni 399 par 1 pika 1.5 të KPRK-së.

Prokuroria e Shtetit aktakuzës së paraqitur i ka bashkangjitur edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë e dt.13.11.2015, deklaratën e të pandehurit të të njëjtës datë, e nënshkruar nga ana e të akuzuarëve M.Y. me mbrojtësin e tij me autorizim av. J.R. dhe të akuzuarit F.H. me mbrojtësin e tij av.I.M. , prokurori i shtetit Bahri Hyseni dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj Agron Çalaj.

Gjyqtari i vetëm gjykues , duke vepruar sipas kësaj akuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit të marrëveshjes me datë 16.09.2016, në të cilën të akuzuarit, mbrojtësit e tyre dhe

prokurori i shtetit u deklaruan përkitazi me marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe duke i propozuar Gjykatës pranimin e saj sipas kushteve të përcaktuara.

2. Vlerësimi i marrëveshjes së pranimit të fajësisë

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoi se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 233 par. 18 të KPP-ës:

- të akuzuarit e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësi e të akuzuarëve M.Y. me mbrojtësin e tij me autorizim av. J.R.dhe të akuzuarit F.H. me mbrojtësin e tij av.I.M.

- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë nga mbrojtja e të akuzuarëve dhënë gjatë procedurës hetimore,shiqimi i librezës së qarkullimit me nr..... ,dhe librezës me nr. të VRD-së:..... si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të siguruar gjatë procedurës hetimore;

- si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Andaj, pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

3. Vlerësimi ligjor

Duke vlerësuar në aspektin juridik Gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarëve M.Y. dhe F.H. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale me të cile kryen veç e veç veprën penale “raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve”nga neni 399 par 1 pika 1.5 të KPRK-së.

4. Vlerësimi për dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 75 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-ës dhe gjeti se edhe me anë të aplikimit të kësaj dispozite të zbutjes bazuar në faktin se të akuzuarit kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve, andaj edhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i përcaktuar me nenin 41 të KPK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, ka obliguar që të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40/katërdhjetë/€uro, në mënyrë solidare e cila është caktuar duke pasur parasysh komplikueshmërinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ –DEGA NË SHTËRPCË
P.nr. 145/15 me 16.09.2016.

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, vetëm nga ana e prokurorit të shtetit përkitazi me sanksionin penal të shqiptuar (neni 233 par.13 i KPP-së), pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë.